



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2026/0213**  
**Data e Vendimit: 17.04.2026**

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 dhe nenit 109 paragrafi 2 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092 dhe nenit 64 të Rregullores Nr.002/2022 për Prokurim Publik pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik OE “Bahri Asllani” B.I. lidhur me aktivitetin e prokurimit “ Zgjerimet ne Rrjetin Qendror – Modernizimi i Rrjetit IP MPLS dhe NTP Serverve” me numër të prokurimit TK-25-6587-1-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Telekom i Kosoves SH.A., Kryesuesi i Sekretariatit të Organit Shqyrtues te Prokurimit z. Ardian Behra me 16/04/2026, mori këtë:

## Vendim

**I.Hedhet si e jashtafatshme**, ankesa e “Bahri Asllani” B.I. me nr. të protokollit 2026/0213, e datës 03/04/2026, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit Zgjerimet ne Rrjetin Qendror – Modernizimi i Rrjetit IP MPLS dhe NTP Serverve me numër të prokurimit TK-25-6587-1-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Telekom i Kosoves SH.A.

**II. lejohet**, autoritetit kontraktues – Telekom i Kosoves SH.A., që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit Zgjerimet ne Rrjetin Qendror – Modernizimi i Rrjetit IP MPLS dhe NTP Serverve me numër të prokurimit TK-25-6587-1-1-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

**III.** Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## Arsyetim

*-Faktet dhe rrethanat procedurale-*

Autoriteti Kontraktues, Telekom i Kosovës Sh.A., me datë 25.07.2025 ka publikuar Njoftimin për Kontratë (B05) për aktivitetin e prokurimit me titull: “Zgjerimet në Rrjetin Qendror – Modernizimi i Rrjetit IP MPLS dhe NTP Serverëve”, me numër të prokurimit TK-25-6587-1-1-1.

Operatori ekonomik “Bahri Asllani” B.I., me datë 18.03.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues. Autoriteti Kontraktues, me datë 24.03.2026, ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim.

I pakënaqur me këtë vendim, operatori ekonomik ankues ka parashtruar ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) përmes sistemit elektronik të prokurimit, me datë 03.04.2026, në ora 16:06.

*- Administrimi dhe Vlerësimi i provave -*

Nga provat e administruara është vërtetuar se vendimi i Autoritetit Kontraktues për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim është marrë me datë 24.03.2026.

Në përputhje me nenin 109, paragrafi 2 të Ligjit për Prokurim Publik, si dhe nenin 64.1 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik, pala e pakënaqur ka të drejtë të parashtojë ankesë pranë OSHP-së brenda afatit prej dhjetë (10) ditësh nga dita e pranimit të vendimit të Autoritetit Kontraktues në procedurën paraprake.

Duke llogaritur afatin ligjor prej dhjetë (10) ditësh nga data 24.03.2026, rezulton se afati i fundit për paraqitjen e ankesës ka qenë data 03.04.2026 deri në përfundim të orarit zyrtar të punës. Ndërsa, edhe nëse merret si referencë dita pasuese (07.04.2026) sipas mënyrës së llogaritjes së afateve, rezulton se ankesa e paraqitur më 03.04.2026 në ora 16:06 konsiderohet e dorëzuar jashtë afatit ligjor, për shkak të tejkalimit të afatit të përcaktuar për parashtrim.

Rrjedhimisht, konstatohet se operatori ekonomik ankues nuk ka vepruar në përputhje me afatet imperative të përcaktuara me dispozitat ligjore në fuqi.

*-Përfundimi-*

Bazuar në të gjitha provat dhe faktet e paraqitura më lart, konstatohet se ankesa e operatorit ekonomik “Bahri Asllani” B.I., e paraqitur pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit për aktivitetin e prokurimit me titull: “Zgjerimet në Rrjetin Qendror – Modernizimi i Rrjetit IP MPLS dhe NTP Serverëve”, me numër të prokurimit TK-25-6587-1-1-1, është e jashtafatshme.

Ankuesi nuk ka respektuar afatin ligjor për parashtrimin e ankesës, të përcaktuar me nenin 109 të Ligjit për Prokurim Publik dhe nenin 64 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik.

Në këtë drejtim, theksohet se neni 64.3 i Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik përcakton qartë se është përgjegjësi e parashtruesit të ankesës që ankesa të përgatitet dhe të dorëzohet në OSHP para skadimit të afatit të fundit për parashtrim. Nëse parashtruesi dështon të përgatisë dhe paraqesë ankesën brenda afatit kohor për shkak të çfarëdo problemi teknik që ndodh në dy (2) orët e fundit para skadimit të afatit, përgjegjësia për këtë dështim bie mbi vetë parashtruesin e ankesës.

Rrjedhimisht, edhe në rastet kur ankuesi mund të pretendojë vështirësi teknike në sistemin e-prokurimit, një pretendim i tillë nuk e justifikon tejkalimin e afatit ligjor për parashtrim të ankesës.

Për rrjedhojë, ankesa hedhet si e jashtafatshme dhe nuk hyn në shqyrtim meritor nga Organi Shqyrtues i Prokurimit.

Në përputhje me nenin 31, paragrafi 4 të Rregullores së Punës së OSHP-së, duke qenë se operatori ekonomik ankues ka paguar tarifën e ankesës, e njëjta i kthehet. Ankuesi obligohet që kërkesën për kthimin e mjeteve ta parashtrijë brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh, konform nenit 31, paragrafi 6 të rregullores së sipërcituar.

Kryesuesi i Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit, bazuar në të gjitha që u tha si më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



**Ardian Behra**  
Kryesues i Sekretariatit

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

### **Vendimi t'i dorëzohet:**

- **AK - TELEKOMI I KOSOVËS SH.A.**
- **OE - Bahri Asllani**
- Arkivës së OSHP-së: